



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2515/1 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit ka administruar shkresën tuaj nr. 14981 prot., datë 25.11.2024, administruar me tonën me nr. 2515 prot., datë 02.12.2024, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”, së bashku me relacionin shpjegues. Më poshtë, gjeni vlerësimin dhe sugjerimet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Fillimisht, vërejmë se qëllimi i këtij projektvendimi është krijimi i bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar, i cili shërben për të mbajtur, ruajtur dhe përdorur lehtësisht të dhënat, si dhe për të identifikuar nevojat që janë realizuar deri më tani e ato që duhet të realizohen në të ardhmen, duke përfshirë në këtë bazë të dhënash institucionet ligjzbatuese për strehimin social, si dhe duke pasqyruar një situatë reale të hapave që janë ndërmarrë me zbatimin e ligjit organik.

Ndërkohë, pas analizimit të legjislacionit specifik, në zbatim të së cilit ushtron veprimtarinë ministria përgjegjëse për strehimin (në cilësinë e kontrolluesit), konkretisht ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, vërejmë se, ky i fundit legjitimohet të administrojë dhe të mbledhë informacione dhe të dhëna nga ndërveprimi me baza të tjera të dhënash shtetërore.

Për sa më lart, meqenëse proceset përpunuese të të dhënave personale të parashikuara në këtë projektvendim janë të një game të gjerë dhe përfshijnë disa institucione që do të jenë pjesë e këtij procesi, respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes në tërësi i projektvendimit, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve në vijim.

Nga shqyrtimi i përmbajtes së pikës 8, të projektvendimit, përcaktohen autoritetet publike të cilat do të aksesojnë bazën e të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar. Referuar pikës 9, të projektvendimit, rezulton se, nuk janë specifikuar nivelet e aksesit dhe rolet që do të kenë në sistem të gjithë autoritetet publike kompetente, konkretisht për Entin Kombëtar të Banesave dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit sugjeron që, nga ana juaj, të merren masa për rregullimin e nivelit të aksesit për të gjithë institucionet e përmendura në pikën 8, të projektvendimit.

Në lidhje me pikën 9, të projektvendimit, sugjerojmë të riformulohet duke parashikuar dhe përcaktuar, si vijon:

- a. strukturën përgjegjëse që ka akses në sistemin e bazës së të dhënave të strehimit social;
- b. roli i punonjësve që do të aksesojnë bazën e të dhënave (administrator/regjistruar/lexues etj.);
- c. nivelin e aksesit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori përdoruesish.

Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për atë që lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij.

Ndërkohë, caktimi i një afati kohor mbi ruajtjen e të dhënave përbën një nga kriteret bazë në zbatim të germës d), të nenit 5, të Ligjit, sipas së cilit parashikohet që mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Për sa më sipër, duke qënë se në pikën 1, të projektvendimit, parashikohet publikimi i bazës së të dhënave në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për strehimin dhe njësive të vetqeverisjes vendore, me qëllim që publikimi t'i shërbejë interesit publik, duke respektuar njëkohësisht edhe të drejtën e privatësisë të subjekteve të të dhënave, sugjerojmë shtimin e një pike pas pikës 9, të projektvendimit, me këtë përmbajtje, duke përcaktuar edhe afatin përkatës: *“Publikimi në faqen e internetit të bazës së të dhënave, do të ruhet, për atë që është e nevojshme, por jo më shumë se (...) ..”*.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektvendimi, vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi